

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, Kolegjin Universitar të Sipërmarrjes dhe Administrimit në Lublin, Poloni, në kuadër të programit Erasmus +.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023 në Kolegjin Universitar të Sipërmarrjes dhe Administrimit në Lublin, Poloni.

Kush mund të aplikojë:

Studentët e UMT-së të cilët gjatë vitit akademik 2022-2023 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë bachelor si dhe studentë të vitit të parë dhe të dytë të masterit nga Fakultetet:

-Fakulteti i Ekonomisë

-Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT

-Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (Vetem studentët të Programit Arkitekturë).

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Për tu pajisur me lendet që do të zhvillohen gjatë semestrit të dytë, lutemi kontaktoni në adresën e e-mailit: edoku@umt.edu.al

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit;
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2; Nqs mungon certifikata e njohur ndërkombëtarisht atëherë pajisuni me një certifikatë nga lektori i gjuhës angleze në UMT.
- Dokumenti Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*



KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Kolegjin Universitar të Sipërmarrjes dhe Administrimit në Lublin, Poloni lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2022/2023 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Afati për aplikim: **11 Dhjetor, 2022.**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!